

**Fjala e Akademik Fejzullah Krasniqit me rastin e marrjes së çmimit Marin Barleti nga Universiteti Publik “Kadri Zeka” në Gjilan, me 01.06.2023**

**I nderuar Rektor i UKZ, prof.dr. Bajram Kosumi.**

**I nderuar prorektor Xhevdet Thaqi**

**Të nderuar prorektor e dekan të njësive akademike të UKZ, të nderuar anëtarë të Këshillit drejtues të UKZ ,**

**Të dashur studentë!**

**Zonja dhe zotërinj, mysafir të nderuar**

Fillimisht, falënderoj Rektorin e Universitetit „Kadri Zeka”, Prof.dr. Bajram Kosumin dhe këshillin shkencor për vlerësimet e larta që i kanë shprehur sot mbi veprimtarinë time duke më akorduar çmimin Marin Barleti, historian nga Shkodra i kohës të heroit tonë kombëtar Skënderbeut me rastin e Konferencës vjetore të UKZ, me titull pune: „SHKENCA DHE TEKNOLOGJIA NË PROMOVIMIN E JETËS SË NJERIUT”.

Sa mund ta kuptoj unë, mirënjohje apo çmime të këtij niveli ndahen për njerëzit e shquar e me kontribute të veçanta, për njerëz me cilësi të larta humane të cilët merren denjësisht edhe me punë shkencore, për njerëz të cilët asnjëherë nuk e vlerësojnë punën e vet dhe janë konsekuent të fjalës dhe të paraqitjes së rezultateve të punës së tyre shkencore. Meqë në këtë rast, Ju më keni vendosur në radhën e këtyre njerëzve, për këtë vlerësim tuajin u jam shumë mirënjohës dhe ju falënderoj në radhë të parë juve, rektor Kosumi dhe të gjithë anëtarët e stafit akademik të UKZ.

Më lejoni që, në vazhdim, përderisa jemi në një konferencë shkencore, në mënyrën si e kërkon rasti, t’i them disa fjalë se si unë e kuptoj shkencën dhe rolin e saj në shoqëri. Shkenca nuk ka kufi, ajo është universale. Edhe në shkencë rritesh nga rrënjët, pa të cilat thahesh. Dhe më tej, arritjet shkencore dhe vetë ajo kanë kuptim vetëm kur janë në shërbim të plotë të njeriut, të shoqërisë dhe të të gjithë njerëzimit.

Për t’u hedhur në universumin e shkencës, së pari duhet ta njohësh thesarin shkencor të lëmit përkatës, duhet ta duash atë lami dhe duhet të punosh në mënyrë të vazhdueshme në atë

fushë. Shkrimtari i madh francez Viktor Hygo ka thënë: janë dy gjëra të rëndësishme për të pasur sukses në jetë dhe në punë: „Të duash dhe të punosh”.

Jemi dëshmitarë se sot po përjetojmë një ekspansion të fuqishëm të teknologjisë informative me përdorimin e forcave të vogla virtuale, të cilat po e mundësojnë lidhjen e njerëzve pa kufizim në hapësirë dhe kohë. Edhe në këtë rast nuk mjafton vetëm softueri, por nevojitet edhe bartësi material i softuerit, nevojitet përkatësisht edhe hardueri. Kështu, pavarësisht zhvillimit të teknologjisë, njeriu është gjithmonë i nevojshëm.

Nga njohjet dhe kontaktet e vazhdueshme me personelin akademik të **UKZ** nuk ka qenë vështirë të vërtetohet një punë e lëvdueshme, e çmueshme e shumë dinamike e menaxhmentit dhe e personelit akademik të këtij Universiteti në zhvillimin e procesit edukativo-arsimor, shkencor si dhe në lëmin e bashkëpunimit ndërkombëtar. Ky aktivitet është zhvilluar nëpërmjet pjesëmarrjes në projektet e Komisionit Evropian për edukim, të cilët kanë si objektiv fuqizimin e zhvillimit të vendeve në zhvillim, duke krijuar raporte bashkëpunimi me shumë universitete dhe rrjete të universiteteve. Pjesëmarrja në këto projekte kërkon punë dhe profesionalizëm, madje që nga faza e shkrimit të projekteve dhe posaçërisht gjatë fazës së zhvillimit të tyre.

Universitetet që nuk futën në këto projekte, vetëkënaqen me pozitën e tyre dhe për pasojë rriten dallimet, edhe ashtu të mëdhaja, në raport me universitetet evropiane.

Marrja e një mirënjohje Marin Barleti, njeriut që përveq tjerave e ka shkruar librin „Historia e jetës dhe të bëmave të Skënderbeut” nga Universiteti Kadri Zeka në Gjiilan, më sjell kënaqësinë që dëshiroj ta ndajë bashkë me të gjithë stafin akademik dhe studentët e Universitetit, me urimet më të singerta që ky universitet me lehtësi të arrijë të gjitha objektivat e përcaktuara, gjithmonë në funksion të përparimit të komunës dhe tërë vendit.

Qofshi gjithmonë të nderuar! ju faleminderit

Gjiilan, 01.06.2023

Akademik Prof. Dr. Fejzullah Krasniqi